



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:117657

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529166

KF.nr.378/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Agroholding” Sh.P.K. me numër të biznesit 70966182 dhe seli në Suharekë, rr. “Brigada 123” pn, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Legus”, Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, , në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur me 21.03.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit av. N.S., e në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “Agroholding” Sh.P.K. me numër të biznesit 70966182 dhe seli në Suharekë.
- II. Anulohet vendimi nr.prot.126/2021 të datës 07.05.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë-Departamentit të Ankesave, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.06.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të Departamentit të Ankesave nr.162/2021 të datës 07.05.2021, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Si në padi ashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit

kryesor, përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se vendimi i të paditurës duhet të anulohet pasi që me provat e paraqitura pranë gjykatës dhe të dorëzuara pranë të paditurës në lidhje me faturat apo me mospranimin e faturave nga ana e të paditurës, ka bërë shkelje të objektivitetit dhe të rregullave të procedurës administrative, respektivisht parimin e paanshmërisë në kundërshtim të nenit 7 të LKA-se. Më tej ka shtuar se e paditura në mënyrë arbitrare nuk i ka pranuar blerjet e prezantuara të lëkurave nga subjektet "Karadaku" sh.p.k, "Alfa Group" sh.p.k dhe "Engjull" sh.p.k., pasi që është konsideruar nga e paditura se janë transaksione-blerje fiktive, por e paditura për faturat e blerjes në fjalë nuk ka dhënë argument të qartë dhe arsyetim se pse këto fatura, janë fiktive në momentin e transaksioneve të paditësit me bizneset e lartpërmendura për periudhën kontrolluese 2017-2018. Në kohën e transaksioneve tregtare bizneset nuk ishin në listën e të paditurës si biznese që nuk kanë mirëbesim, këto biznese janë biznese aktive të cilat në aktivitetin e tyre biznesor kanë të regjistruar edhe aktivitetin tregtar në shumicë e lëkurave të papërpunuara gjë që dëshmon që transaksionet janë reale dhe të mbështetura në legjislacionin në fuqi. E paditura ATK përmes web faqes së saj i publikon subjektet jo aktive dhe subjekteve që i është tërhequr certifikata e TVSH-së, por që në periudhën me rastin e transaksioneve biznesore bizneseve të lartcekura as nuk i është tërhequr certifikata e TVSh-së e as nuk janë biznese që kanë mungesë mirëbesimi. Për më tepër me provat e paraqitura në gjykatë paditësi për lëkurat e blera nga këto biznese ka kryer eksport në Bosnjë dhe Hercegovinë. Andaj nga te thënat e lartcekura gjykatës i ka propozuar që të aprovet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i të paditurës me nr.126/21 i datës 07.05.2021 apo çështja të kthehet në rishqyrtim apo në rivendosje të e paditura.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 21.12.2021 kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shton se ATK ka kryer vlerësimin duke u bazuar në nenin 19.11 të Ligjit nr.03/I-22 për Administratën Tatimore dhe Procedurat për arsye se Drejtoria e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ka zbuluar fakte të reja përkatësisht transaksione të dyshimta të paditësit me bizneset: "Karadaku" Sh.p.k., "Alfa Group", Sh.p.k. dhe "Engjulli" Sh.p.k. Këto transaksione i ka trajtuar si transaksione fiktive, prandaj vlerësimi është mbështetur në UA nr.03/2015 për zbatimin e ligjit Nr.05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar lidhur me mënyrën e ushtrimit të së drejtës për të zbritur TVSH-në e zbritshme. Së fundi thekson se vendimi i DA-ATK është i bazuar në legjislacionin tatimor, ndërsa padia e paditësit nuk është e bazuar dhe argumentet e parashtruara nga paditësi nuk janë të mjaftueshme për të ndryshuar Njoftim ri vlerësimet e konstatuara sipas kontrollit të kryer apo për të liruar paditësin nga detyrimet tatimore konform legjislacionit tatimor dhe fakteve të proceduara. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet

padia e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i DA të ATK-së nr.126/2021 i datës 07.05.2021 si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ndërsa me parashtrësën e datës 19.03.2024, gjykatën e ka njoftuar se nuk mund të prezanton në seancë duke kërkuar që e njëjta të vepron konform me nenin 38 par 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 21.03.2024, ka administruar provat si në vijim: vendimi kontestues nr.126/2021 i datës 07.05.2021 Ankesë e datës 15.04.2021 Raporti i kontrollit i datës 22.03.2021, Certifikatë e regjistrimit "Engjulli" Sh.P.K, Kontratë e datës 15.10.2015, Kontratë e datës 15.04.2017, Faturë nr. 02/2017, Faturë nr. 03/2017, Transferet bankare të datave: 27.04.2017, 12.04.2107, 11.04.2017, Transaksionet bankare të datave 06.06.2017, 31.05.2017, Faturë nr. 13/2017, Transaksion bankar 31.10.2017, Faturat nr. 12/17, 11/17, 10/17, 09/17,08/17, 07/17, Faturat dhe transkisionet bankare, Certifikatë veterinare nga AUV, EUR1, CMR dhe faturë 477-220-001-17, Pagesë e dt. 27.04.2017, Faturë A/2, DUD R 9244, Blerje qytetare (informata nga palët e treta), Faturë nr. 1/17, Kontratë e datës 13.12.2016, Certifikatë për biznesin "Karadaku-N" Sh.P.K, Certifikatë e TVSH-së për Karadaku-N" sh.p.k Kontratë e dt. 01.12.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga vendimi i kontestuar i ATK-së me nr.126/2021 i datës 07.05.2021, gjykata konstaton se e paditura ATK ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar Njoftim Rivlerësimin e tatimit shtesë të caktuar me kontrollë. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se Drejtoria e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ka zbuluar fakte të reja përkatësisht transaksione të dyshimta të paditësit me bizneset: "Karadaku" Sh.p.k., "Alfa Group", Sh.p.k. dhe "Engjulli" Sh.p.k. Këto transaksione i ka trajtuar si transaksione fiktive, prandaj vlerësimi është mbështetur në UA nr.03/2015 për zbatimin e ligjit Nr.05/L-037 Për tatimin mbi vlerën e shtuar lidhur me mënyrën e ushtrimit të së drejtës për të zbritur TVSH-në e zbritshme.

Nga vendimi i kontestuar rezulton se ai përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Gjykata gjen se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar përveç konstatimit se paditësi nga të dhënat e Divizionit të hetimeve tatimore dhe inteligjencës është konstatuar se bizneset kanë transaksione fiktive, nuk ka sqaruar faktin se si është vërtetuar se paditësi nuk ka vepruar konform nenit të lartcekur. Ndërsa nga raporti i kontrollit, si arsyetim i mospranimit të këtyre faturave ceket se bizneset dhe pronarët e tyre janë në procedurë penale për transaksione të shitjeve të dyshuara fiktive, dhe këto blerje të kryera nga biznesi në procedurë kontrollit janë blerje të dyshuara si blerje me transaksione fiktive.

Në këtë drejtim gjykata e ka të pa qartë faktin se si është ardhur deri tek konstatimi se paditësi ka kryer blerje fiktive, nuk është e qartë nëse edhe ndaj paditësit është iniciuar procedurë penale, a kanë pasur këto biznese certifikatë aktive apo u është anuluar certifikata e TVSH-së në kohën kur edhe janë realizuar blerjet, a janë kryer procedura tjera me qëllim të verifikimit se si ka vepruar blerësi me mallrat e blera. Gjykata vlerëson se vetëm konstatimi se kontrolli është mbështet nga të dhënat e Divizionit të Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ku është konstatuar se bizneset e lartcekura janë të dyshuara për transaksione fiktive, është i pamjaftueshëm. Nuk është e qartë nëse të gjitha transaksionet janë konsideruar fiktive, a janë kontrolluar nëse këto fatura kanë qenë të regjistruara në librat dhe regjistrimet e paditësit dhe nëse kanë ekzistuar pagesa siç parashihet me ligj për këto fatura. Blerjet e paditësit a janë të përfshira në transaksionet e dyshimta. Gjykata konstaton se e paditura në vendimin e kontestuar, por edhe gjatë procedurës gjyqësore në këtë konflikt administrativ, nuk e ka kontestuar faktin se blerjet e paditësit nga subjektet e lartpërmendura nuk kanë qenë të regjistruara në librat dhe regjistrimet e paditësit, nuk e ka kontestuar faktin as që paditësi këto blerje i ka raportuar në transaksionet e blerësit mbi 500.00 €, siç kërkohet me nenin 13 par.7 të Ligjit nr.03/L-222, nuk e ka kontestuar as faktin se pagesat e këtyre faturave janë bërë përmes llogarive bankare.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nuk mund të cilësohen biznese me transaksione të dyshimta fiktive, të cilat në kohën kur kanë zhvilluar transaksione ekonomike me paditësin kanë pasur certifikatën valide të regjistrimit të biznesit, kanë pasur certifikatën e numrit fiskal të lëshuar nga vet e paditura, si dhe kanë pasur certifikatën valide të TVSH-së të lëshuara nga vet

e paditura. Në këtë pikë gjykata vlerëson se në riprocedurë e paditura duhet ti sqaroj faktet e lartcekura.

Me nenin 37 të Ligjit për TVSH është paraparë “1. E drejta për zbritje lind në kohën kur tatimi i zbritshëm bëhet i ngarkueshëm. 2. Për të ushtruar të drejtën e tij për zbritje të TVSH-së së zbritshme, personi i tatueshëm duhet që së paku: 2.1. në lidhje me të gjitha zbritjet e referuara në Kapitullin e XIII të këtij ligji të mbajë një faturë ose një dokument që shërben si faturë në pajtueshmëri me Kapitullin XV të këtij ligji. Në lidhje me zbritjet sipas nën-paragrafit 2.2., të paragrafit 2, të nenit 36 të këtij ligji të ketë një dokument importi “Dokumenti Unik Doganor - DUD”, në të cilin ai është i cekur si pranues i dërgesës apo importues dhe i cili e cek shumën ose mundëson llogaritjet e obligimit tatimor.”

Gjykata thekson se paditësi para të paditurës në procedurë administrative, por edhe kësaj gjykate në këtë konflikt administrativ i ka paraqitur dokumentet ku përfshihen faturat e blerjes nga subjektet të cilat i posedojnë të gjitha elementet e përcaktuar me nenin 45 të Ligjit nr.05/L-037 Ligjit për TVSH, pagesat bankare të cilat janë bërë shitësve për këto blerje sipas faturave të lëshuara.

Andaj, Gjykata vlerëson se ka kontradikta lidhur me plotësimin e kushteve për mospranimin e TVSH-së së zbritshme për faturat e blerjes nga subjektet Karadaku' Sh.P.K, "Alfa Group' sh.p.k dhe "Engjull" sh.p.k, të përmendura në faqen 5 dhe 6 të Raportit të kontrollit të datës 22.03.2018, ngase siç u tha më lartë nuk është e qartë se a kanë qenë të regjistruara në ARBK këto biznese, a kanë pasur numra aktiv fiskal, a janë çrregjistruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në kohën e ndodhjes së transaksioneve me paditësin. Nuk janë paraqitur dëshmi se këto subjekte nuk janë gjendur në adresat e dhëna për regjistrim në ARBK, për çka do të rezultonte me mos lëshim të numrit fiskal, përkundrazi Gjykata nga shkresat e lëndës konstaton se këtyre subjekteve i'u ka lëshuar numrat fiskal, dhe se e paditura nuk ka dëshmuar nëse këtyre bizneseve ju ka anuluar certifikatën e TVSH-së në periudhën kur paditësi ka zhvilluar transaksione me këto subjekte.

Meqenëse e paditura në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur prova materiale të cilat do të vërtetonin se paditësi ka realizuar transaksione me biznese fiktive dhe si pasojë të njëjtat nuk janë pranuar si të rregullta, për arsye se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta, pastaj në pikat esenciale faktet nuk janë vërtetuar, rrjedhimisht edhe nga

faktet të cilat janë vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj gjykata vendosi të anuloi aktin e kontestuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Rrjedhimisht, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje që fillimisht të deklarohet se mbi bazën e cilave provave dhe fakteve relevante e ka vërtetuar faktin se paditësi ka të realizuara blerje fiktive, cili ishte statusi i bizneseve në kohën e realizimit të blerjeve, të cek bazën ligjore për një veprim të tillë si dhe praktikën e organit të paditur në trajtimin e rasteve të ngjashme.

Gjykata vlerëson se të metat e lartcekur janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, kështu që gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marr konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.378/22, datë 29.03.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.